



Pranuar / Dostiguar Prilbjen/Prilbjen Received/Delivered	10-02-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPM SHCK	664/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOV

A.nr.11/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca, anëtar, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr. 11/2020, të datës 16.01.2020, të ankueses me adrese banimi _____ nga Komuna e Prishtinës, sipas Aktgjykimit A.nr.320/2020, të datës 16.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “kompensimi material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 10.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa A.nr.11/2020 e datës 16.01.2020 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Sekretari i Përgjithshme i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 18.07.2019, me numër 3092/2019, ka nxjerr vendim lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civil _____ duke i njohur të drejtën e një pagë përcjellëse në rastin e pensionimit.

Ankuesja _____ me datë 19.09.2019, me numër protokolli 3996/20169, me ankesë i është drejtuar komisionit të ankesave, të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ankuesja _____ në pajtim me Ligjin Nr. Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 16.01.2020, me numër protokolli 103/2020 me ankesë i është drejtuar KPM SHCK-së, me pretendimet ankimore se organi _____

i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë pagesën e dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, dhe tri pagave jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.01.2020, me numër protokoll 210/2020 ka njoftuar ankuesen se nuk mundë të shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesën A.nr.11/2020, të datës 16.01.2020, për shkak se Këshilli nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 28.01.2020, të KPMSHCK-së përmes padisë ka hapur konflikt administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 16.12.2021, ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.320/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 28.01.2020 duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendosë lidhur me ankesën A.nr. 11/2020 të datës të datës 16.01.2020 të ankueses

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.11/2020 e parashtruar më datë 16.01.2020 me numër protokoll 103/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shënimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A.nr. 320/2020, i datës 16.12.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative; Vendimi nr.3092 i datës 18.07.2019; kërkesa e datës 19.09.2019, drejtuar Komisionit të Ankesave të MKRS; Njoftimi i datës 28.01.2020, i KPMSHCK-së; Përgjigje në kërkesë e datës 28.01.2020, me numër protokoll 350/2020, me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se organi i punësimit Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, pas arritjes së moshës së pensionimit nuk i ka bërë pagesën e dy (2) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, dhe tri pagave jubilarë, sipas Marrëveshje së Përgjithshëm Kolektive të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshme i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 18.07.2019, ka nxjerr vendimin nr.3092/2019 për përfundimin e marrëdhënies së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, për nëpunësen civile Farija Muhadri, duke i njohur të drejtën e një page përcjellëse me rastin e pensionimit, me të cilin vendim e ka njoftuar se nga data 19.08.2019, largohet nga lista e pagave, ndërsa ankuesja më datë 19.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa tek Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, pasi që ankuesja nuk ka marr përgjigje nga organi i punësimit me



datën 16.01.2020,ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të heshtjes administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative e ka parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor, duke vepruar në kundërshtim 127, paragrafi 4 . të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se; **4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.** Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga pala ankuese si dhe përgjigjen në ankesë të siguruar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka konstatuar se ankuesja nuk ka marr përgjigje nga Komisioni i Ankesave i MKRS, dhe se ankesa në KPMSHCK kundër heshtjes Administrative është parashtruar jashtë afatit ligjor.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.11/2020,datë 10/02/2022**

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses;
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së